



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

**Procesverbali nga mbajtja e takimit publik me qytetarë për
Ndërtimin e parkut të sportit urban në lagjen “Dardania” në
Prizren**

Procesverbali për Ndërtimin e parkut të sportit urban në lagjen “Dardania” në Prizren mbahet me qëllim të dokumentimit zyrtar të diskutimeve, propozimeve dhe rekomandimeve të paraqitura gjatë takimeve me qytetarë, institucionet relevante dhe grupet e interesit. Përmes këtij dokumenti sigurohet transparencë në procesin e planifikimit dhe realizimit të projektit, si dhe evidentohen të gjitha qëndrimet dhe kërkesat e pjesëmarrësve lidhur me përmbajtjen dhe funksionalitetin e parkut sportiv urban.

Mbajtja e procesverbalit ka rëndësi të veçantë edhe për garantimin e një procesi të rregullt administrativ dhe institucional, duke krijuar bazë për vendimmarrje dhe koordinim të mëtejshëm ndërmjet palëve përgjegjëse. Po ashtu, procesverbali shërben si dëshmi zyrtare për ecurinë e aktiviteteve dhe përfshirjen e komunitetit lokal në këtë projekt, i cili synon përmirësimin e hapësirave publike dhe promovimin e aktiviteteve sportive e rekreative në lagjen “Dardania”.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **06:05.2026** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/Njoftim-per-takim-publik-per-Ndertimin-e-Parkut-te-Sportit-ne-lagjen-Dardania-ne-Prizren.pdf>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewMeeting.php?MeetingID=431>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-takimit-publik-per-ndertimin-e-parkut-te-sportit-urban-ne-lagjen-dardania-ne-prizren/>

Takimi është mbajtur në sallën e Administratës Komunale dhe ka filluar në orën 10:05.

-Takimi publik me qytetarë për projektin e Parkut Sportiv në lagjen “Dardania” u hap nga Haziz Krasniqi, Zyrtar i lartë për Informim i cili fillimisht i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe interesimin e treguar për këtë projekt me rëndësi për komunitetin. Gjatë fjalës hyrëse u theksua rëndësia që ka krijimi i hapësirave sportive dhe rekreative për banorët e lagjes, veçanërisht për të rinjtë dhe fëmijët.

Në këtë takim u prezantuan detajet kryesore të projektit, që synon krijimin e një hapësire moderne sportive dhe rekreative, e cila do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe promovimin e aktiviteteve sportive në komunitet. Po ashtu, qytetarët u njoftuan me përmbajtjen e projektit, fazat e realizimit dhe përfitimet që pritet t’i sjellë ky investim për lagjen “Dardania”.

Haziz Krasniqi theksoi se takimet publike janë një pjesë e rëndësishme e procesit vendimmarrës, duke u dhënë qytetarëve mundësinë që të japin sugjerime, komente dhe rekomandime lidhur me projektin. Ai shtoi se bashkëpunimi me qytetarët mbetet thelbësor për realizimin e projekteve që janë në interes të përgjithshëm dhe në shërbim të komunitetit.

-Prezantimi i projektit të Parkut Sportiv në lagjen “Dardania” u bë nga Alban Krasniqi, Zyrtar i Lartë për Ndërtimtari në Drejtorinë për Shërbime Publike në Komunën e Prizrenit i cili para të pranishmëve prezantoi konceptin dhe përmbajtjen e projektit, duke theksuar rëndësinë e krijimit të një hapësire moderne sportive dhe rekreative për banorët e kësaj lagjeje. Ai nënvizoi se projekti synon të krijojë kushte më të mira për zhvillimin e aktiviteteve sportive, sociale dhe rekreative, veçanërisht për të rinjtë dhe fëmijët.

Gjatë prezantimit, Alban Krasniqi shpalosi elementet kryesore të projektit, përfshirë hapësirat sportive, zonat rekreative, gjelbërimin dhe infrastrukturën përcjellëse që do të jenë pjesë e parkut. Po ashtu, ai informoi qytetarët lidhur me fazat e realizimit të projektit dhe ndikimin pozitiv që pritet të ketë ky investim në përmirësimin e jetës së komunitetit dhe krijimin e një ambienti më funksional për banorët e lagjes “Dardania”.

Në fund të prezantimit, u theksua rëndësia e bashkëpunimit me qytetarët dhe marrja parasysh e komenteve dhe sugjerimeve të tyre gjatë procesit të realizimit të projektit, me qëllim që parku të përmbushë nevojat dhe kërkesat e komunitetit lokal.

Komentet e qytetarëve:

Blerta Osmani, kërkoj të di se kur pritet të realizohet ky projekt, pasi që një projekt i tillë është i mirëseardhur për qytetarët të cilët jetojnë në këtë lagje, lagje e cila ka një numër të madh të banorëve.

Alban Krasniqi-jemi duke i ndjekur të gjitha procedurat të cilat kërkohen nga ministria dhe me pas mbetet të shihet se a do të aprovohet dhe realizohet projekti gjatë këtij viti, pra vitit 2026. Si do që të jetë ne do të kemi mundësi, që të takohemi me ju dhe qytetarë tjerë për të diskutuar me ju për këtë projekt dhe projektet tjera.

Takimi ka përfunduar në orën 10:30.

Me 14.05.2026, është mbajtur takimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e takimit:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/u-mbajt-takimi-publik-per-projektin-e-parkut-sportiv-ne-lagjen-dardania/>

Procesmbajtës:

Alban Krasniqi

Haziz Krasniqi